



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:167095

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05423286

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.437/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në lëndën penale ndaj të akuzuarve A...M..... dhe Sh....H..... për shkak të veprave penale: A...M..... për veprat penale: Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 par.1 të KPRK-së, ndërsa Sh....H..... për shkak të veprës penale Deklarimet e rreme nga neni 384 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.1188/2023 të datës 08.09.2023 (2023:0048209), pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 20.02.2024 në prezencë të prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarve i pandehuri A...M..... i cili është sjellë nga Njësi i përçjelljen e të burgosurve, mbrojtësi i të pandehurit të parë, avokat Naim Rudari sipas autorizimit me shkrim, i pandehuri Sh....H....., me datë 22.02.2024, ndërsa me datë 07.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarve:

A...M....., nga i ati S....., e ëma M..., e vajzërisë D....., i lindur më datë 16.07.1994 në Sh..., Shqipëri, me vendbanim në lagjen "S.....", Sh....-Shqipëri, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

Sh....H....., nga i ati H....., e ëma Z....., e vajzërisë T..., i lindur me datë 10.07.1968, në fshatin K....., Komuna e Mitrovicës, me vendbanim në rrugën "K.....", nr....., Mitrovicë, tregtar, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të përfunduar shkollën fillore, me numër personal i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I

I pandehuri A...M.....:

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1. Më datë 31.07.2023, në Agjencinë për Regjistrimin Civil-Drejtoria për Pajisje me Dokumente, Mitrovicë, i pandehuri me dashje ka vë në lajthim zyrtaren për regjistrimin civil në atë mënyrë që në momentin e aplikimit për lëshimin e letërnjoftimit ka

paraqitur ekstraktin me numër, të lëshuar në B....., Gjakovë në emër të J.... K..... dhe letërnjoftimin të shtetit të Belgjikës me emrin J.... K....., me qëllim që të pajisjet me letërnjoftim në emër të personit tjetër.

Me këtë ka kryer veprën penale: Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së.

2. Me datë 31.07.2023, në Agjencinë për Regjistrimin Civil-Drejtoria për Pajisje me Dokumente, Mitrovicë, i pandehuri me dashje shfrytëzon pa autorizim mjetin e identifikimit të personit tjetër dhe atë ekstraktin me numër të lëshuar në B....., Gjakovë në emër të J.... K.....

Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 paragrafi 1 të KPRK-së.

II

I pandehuri Sh....H.....:

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë 31.07.2023, në Agjencinë për Regjistrimin Civil-Drejtoria për pajisje me Dokumente, Mitrovicë, i pandehuri me dashje para zyrtares përgjegjëse, në cilësinë e dëshmitarit në procedurën administrative, jep deklaratë të rreme, në mënyrë që për të pandehurin A...M..... ka dëshmuar nën përgjegjësi morale dhe personale se është personalisht ai dhe se identiteti i tij dhe të dhënat personale të tij janë të vërteta, deh atë: J.... K.... me numër personal, edhe pse e ka ditur se një fakt i tillë nuk është i vërtetë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Deklarimet e rreme nga neni 384 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 42, 43, 69, 70, 76 dhe 395, 336 dhe 384 të KPRK-së dhe nenit 270, 359, 360, 364, 366, 449, 450 dhe 452 të KPP-së e:

G J Y K O N

Të pandehurin A...M.....:

Për veprën penale sipas pikës I të dispozitivit, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Për veprën penale sipas pikës II të dispozitivit, Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 paragrafi 1 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit A...M..... i:

SHQIPTON

- I. DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë e këtij Aktgjykimi, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 02.08.2023 e deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në kohëzgjatje prej gjashtëmbëdhjetë (16) muaj.
- II. Gjykata, me aktvendim të veçantë, të pandehurit ia ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi por jo më shumë se sa dënimi i shqiptuar sipas pikës I.

Të pandehurin Sh....H.....:

- III. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- IV. DËNIM ME GJOBË në shumë prej një mijë (1,000.00) euro, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo njëzetë (20) euro gjobë të papaguar, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.
- V. Konform nenit 270 të KPP-së, konfiskohen sendet dhe atë: Letërnjoftimi me numër serik me të dhënat e J.... K..... me numër personal si dhe një Letërnjoftim me numër serik me të dhënat e V.... F..... i lëshuar nga Republika e Shqipërisë.
- VI. URDHËROHET kthimi i telefonit I phone 8, me ngjyrë të zeze, pronarit të tij.
- VII. Obligohen të pandehurit, që secili veç e veç, t'i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 50 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- VIII. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën ndaj të pandehurit A...M....., për shkak të veprave penale: Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Vjedhja e identitet dhe pajisja e qasjes nga neni 336 par.1 të KPRK-së, dhe ndaj të pandehurve Sh....H..... për shkak të veprës penale Deklarimet e

rreme nga neni 384 par.1 të KPRK-së dhe B...D.... për shkak të veprës penale Deklarimet e rreme nga neni 384 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.10.2023, në të cilën seancë, të pandehurit A.... M.... dhe Sh....H....., ishin deklaruar të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohen, ndërsa i pandehuri i tretë, B...D....., e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej dhe për të njëjtin, kjo Gjykatë kishte veçuar procedurën.

Përmes Aktvendimit me numër P.nr.437/2023, të datës 07.11.2023, kjo Gjykatë kishte refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, të paraqitura nga avokati mbrojtës i të pandehurit A...M....., Naim Rudari dhe i pandehuri Sh....H.....

Me Aktvendimin PN.nr.1628/2023, të datës 28.12.2023, Gjykata e Apelit e Kosovës, kishte refuzuar ankesat e mbrojtësit të pandehurit A...M....., avokat Naim Rudari dhe të pandehurit Sh....H....., ndaj aktvendimit të kësaj Gjykate për refuzimin e kërkesave për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 31.01.2023 dhe 07.02.2024, pas së cilës seancë edhe kishte caktuar datën e shpalljes së aktgjykimit, mirëpo përmes procesverbalit të datës 12.02.2024, kjo Gjykatë kishte vendosur që të rihapë shqyrtimin kryesor, me të vetmin qëllim që të pandehurit Sh....H....., t'i ipet edhe një mundësi që të paraqes fjalën përfundimtare. Me datë 20.02.2024, kjo Gjykatë ka mbajtur edhe një seancë, në të cilën i pandehuri i dytë, Sh....H....., ka refuzuar dhënien e fjalës përfundimtare ashtu që gjykata shpalljen e aktgjykimit e ka bërë me datë 22.02.2024.

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit A...M..... dhe Sh.... H.... si dhe mbrojtësi i të pandehurit të parë, A...M....., avokati Naim Rudari, sipas autorizimit me shkrim. Në seancat e shqyrtimit kryesor janë administruar provat materiale të propozuara në aktakuzë dhe është dhënë fjala përfundimtare, ndërsa në aktakuzë nuk kishte të propozuara prova personale përkatësisht dëshmitar.

Fjala përfundimtare e palëve.

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës kundër të pandehurve, duke theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilat akuzohen. Tutje ka theksuar se ky dyshim, është vërtetuar gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe atë nga provat e administruara, përkatësisht nga provat materiale të cilat prokurori i shtetit i ka numëruar taksativisht në fjalën e tij. Me tej ka shtuar se nuk është aspak kontestues fakti se i pandehuri A...M..... ka kryer veprat penale si në dispozitiv të aktakuzës dhe atë se i njëjti ka legalizuar përmbajtjen e rreme, ashtu që pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil-Drejtorisë për pajisje me dokumente në Mitrovicë ka paraqitur ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me numër seriki lëshuar në fshatin B...., Komuna Gjakovë me datë 11.07.2023 në emër të J.... K...., kopjen e letërnjoftimit me emrin J.... K.... me numër të kartës i shtetit të Belgjikës e

me te cilat ka aplikuar përmes formularit për aplikim me numërne ARC dhe ka bere pagese për procedure urgjente e qe vërtetohet nga fletetransferi për pagese.

Gjithashtu, ne fjalën e saj prokurorja e shtetit ka theksuar se nuk eshte kontestues as fakti se i pandehuri A.... M.... ka kryer veprën tjetër penale vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes dhe atë te personit J.... K.... me numër personal i lindur me date 03.08.1990 ne fshatin D...., Komuna Istog, dhe kjo me se miri vërtetohet nga letërnjoftimi i lëshuar me date 01.08.2023 ne te cilin letërnjoftim janë te dhënat personale te J.... K....., ndërsa fotografia e te pandehurit A.... M.....

Tutje ne fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit ka theksuar se nuk eshte kontestuese se i pandehuri i dyte Sh....H..... ne ARC ka deklaruar rrejshëm dhe kjo vërtetohet nga formulari te cilin e ka nënshkruar me te cilin ne cilësi te dëshmitarit, nen përgjegjësi te plote morale dhe penale ka deklaruar se personi për te cilin ishte aty e qe behet fjale për A... M.... ishte J..... K.... dhe duke shtuar se një fakt te tille e ka pohuar edhe vet i pandehuri ne shqyrtim gjyqësor.

Andaj i ka propozuar gjykatës te njëjtit te shpallen fajtor për veprat penale qe i vihen ne barre.

Mbrojtësi i të pandehurit A...M....., avokat Naim Rudari, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, ka deklaruar se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, nuk është arritur të provohet se i mbrojturi i tij, ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Më tej, në fjalën e tij, mbrojtësi ka shtuar se sa i përket veprës penale Vjedhja e identitetit apo pajisja e qasjes, për të cilën pretendohet se i pandehuri i ka vjedhur identitetin personit me emrin J....K....., në fakt nuk ka asnjë ankesë nga ana e këtij personi se i është vjedhur identiteti, ndërsa sa i përket veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme, kjo vepër, sipas mbrojtësit, është tentuar të kryhet nga ana e të pandehurit por se nuk është kryer. Tutje, mbrojtësi i të pandehurit, ka theksuar se organi i akuzës, e ngarkon të mbrojturin e tij se me një veprim, ka kryer dy veprat penale ashtu që me datë 31.07.2023, i pandehuri ka përdorur Ekstraktin me numër, të lëshuar në fshatin B....., Komuna Gjakovë, në emër të personit J....K..... dhe letërnjoftimin e shtetit të Belgjikës me emrin J....K....., me qëllim që të pajiset me letërnjoftim, por siç ka theksuar mbrojtësi, nga përshkrimi ligjor i veprës penale nga neni 395 paragrafi 1 i KPRK-së, rezulton se eventualisht mund të bëhet fjalë për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni dhe jo nga paragrafi 1. Kjo vepër, sipas mbrojtësit, nuk ka arritur që të kryhej pasi që personat në ARC, e kanë ditur nga fillimi se ai nuk është personi në fjalë, ndërsa sa i përket veprës së dytë penale, duke qenë se prokuroria nuk ka ofruar të dhëna të mjaftueshme se kush është personi J....K....., andaj për këto arsye, duke aplikuar dispozitat e nenit 3, 7, 360 dhe duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, i ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i tij, të lirohet nga akuza.

I pandehuri A...M....., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër se çfarë të shtoj.

I pandehuri Sh....H....., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: ka refuzuar të japë fjalën përfundimtare duke shtuar se nuk i beson kësaj gjykate, ka kërkuar përjashtimin e tërë gjykatës dhe nuk dëshiron që kjo gjykatë të vendos për lëndët e tij.

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike administroi provat si në vijim: shënimi zyrtar nga hetuesi Avdyl Hyseni, i datës 02.08.2023; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 02.08.2023; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 02.08.2023; formulari për aplikim me numër në Agjencinë e Regjistrimit Civil; fletëtransferi për pagesë për MPB ID, me numër të pagesës-Mitrovicë; ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me numër serik, i lëshuar në B....., Gjakovë, me datë 11.07.2023 në emër të personit J.... K....; kopje e letërnjoftimit me emrin J....K..... me numër të kartës, i shtetit së Belgjikës; përgjigja përmes ILEK nga Republika e Shqipërisë lidhur me identifikimin nën emër të V.... F....; të dhënat në lidhjet familjare për personin J....K.....; kopja e letërnjoftimit me emrin J....K..... i lëshuar nga Republika e Kosovës, me numër personal; deklarata e të pandehurit Sh....H..... në Agjencinë për Regjistrim Civil – Drejtoria për Pajisje me Dokumente; të dhënat në lidhje me Urdhërarrestin nga ITERPOL; letërnjoftimi me numër serik me të dhënat V.... F...., i lëshuar nga Republika e Shqipërisë; procesverbali për marrjen e deklaratës së të pandehurit A...M..... (me emrin J....K.....) në PTH Mitrovicë, i datës 29.08.2023; procesverbali për marrjen e deklaratës së të pandehurit A...M..... në PTH Mitrovicë, i datës 29.08.2023; procesverbali për marrjen në pyetje të pandehurit Sh....H..... në SP Mitrovicë Jugu, i datës 02.08.2023; procesverbali për marrjen e deklaratës së të pandehurit Sh....H..... në PTH Mitrovicë, i datës 29.08.2023;

Në aktakuzë, nuk kishte propozime për dëgjimin e ndonjë dëshmitari, ndërsa gjykata ka refuzuar propozimet e të pandehurit Sh....H....., që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen personat M....N....., togeri Q...A.... si dhe ofiqari që ka lëshuar ekstraktin në emër të personit J....K.....

Pas administrimit të provave materiale, i pandehuri A...M..... nuk kanë dhënë mbrojtjen e tij, respektivisht ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje, gjithashtu edhe gjatë marrjes në pyetje në polici me datë 02.08.2023 dhe edhe gjatë marrjes së deklaratës në prokurori, me datë 29.08.2023, i pandehuri ka zgjedhur që të mbrohet në heshtje.

Ndërsa i pandehuri Sh....H....., ka dhënë mbrojtjen e tij në shqyrtimin kryesor, gjithashtu ka deklaruar edhe në marrjen në pyetje në polici me datë 02.08.2023, ndërsa nuk ka dashur që të deklarohet në prokurori për shkak se ka kërkuar përjashtimin e prokurorit të shtetit.

Në deklarimin e tij në polici, i pandehuri Sh....H....., ka theksuar se nuk e njuh fare personin për të cilin ishte ftuar të deklarohej, ndërsa ka shtuar se është bërë dëshmitar pa asnjë interes dhe asnjë cent nuk e ka fituar për këtë.

Në mbrojtjen e dhënë në shqyrtim kryesor, i pandehuri Sh.... ka theksuar se për këtë rast, është vënë në lajthim dhe është mashtruar nga personi M....N....j, kjo pasi që siç ka deklaruar i pandehuri, sikur ta kishte njohur të pandehurin A...M....., nuk do të kishte pranuar asnjëherë që të shkonte në qendrën e regjistrimit civil. Më tej, i pandehuri në mbrojtjen e tij, e ka ripërsëritur faktin se është mashtruar nga M....N....j dhe një person N.N nga Prishtina, të cilët ia kishin sjellë të pandehurin A...M..... dhe duke e lutur që t'i bëhej dëshmitar, gjithnjë duke i garantuar se është personi J....K....., duke e konfirmuar se nuk e njihje dhe as sot nuk e njuh të pandehurin A...M..... Në mbrojtjen e tij, i pandehuri ka deklaruar se pas aplikimit për letërnjoftim, personi

M...N...j, ia ka dhënë 1,600.00 euro dhe se ky person, bashkë me N.N personin nga Prishtina, e kishin lutur të pandehurin që me dorën e tij të dorëzonte aplikacionin në ARC e që mos ta lejonte që këtu i pandehuri A...M..... të dorëzonte atë aplikacion. I pandehuri Sh...H....., ka konfirmuar në mbrojtjen e tij se ka qenë në qendrën e regjistrimit civil, ndërsa arsyeja pse ka shkuar, ka qenë për faktin se ka qenë i joshur dhe i lutur që të ndërmerre veprimet e tij, ndërsa ka sqaruar se ka qenë i joshur nga shuma e parave të cilat i ka marrë. Gjithashtu, i pandehuri në mbrojtjen e tij, pas vështimit të deklaratës së dhënë nën betim në ARC, ka konfirmuar se është deklarata e tij e dhënë dhe e nënshkruar nga ai, por se përmbajtjen nuk ia di as sot. Përfundimisht, i pandehuri Sh...H..... ka konfirmuar se nuk i ka njohur personat J.... K.... dhe as A...M..... deri në atë ditë.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat materiale, ka vërtetuara gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën, nuk ishte kontestuese se i pandehuri i parë, A...M....., me datë 31.07.2023, në procedurë urgjente, kishte aplikuar pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil, Zyra në Mitrovicë, për tu pajisur me letërnjoftim, ndërsa emri i aplikuesit ishte J...K....., i lindur me datë 03.08.1990, nga i ati S.... K.... dhe e ëma P.... K...., dhe ky fakt, përveçse nuk ishte kontestues, vërtetohet edhe nga prova materiale “Formular Aplikimi”, i datës 31.07.2023. Për këtë, i pandehuri kishte bërë edhe pagesën në shumë prej 61.00 euro në Postën e Kosovës dhe ky fakt vërtetohet nga prova materiale “Fletëtransferi”, i datës 31.07.2023.

Për gjykatën, gjithashtu nuk ishte kontestuese se i pandehuri A...M....., me datë 31.07.2023, kishte përdorur Ekstraktin me numër, i lëshuar në Fshatin B....., Komuna Gjakovë, me datë 11.07.2023, me emrin e personit J...K....., si dhe letërnjoftimin e shtetit të Belgjikës me emrin e të njëjtit person, pra J...K....., dhe ky fakt, përveç se nuk është kontestuar nga palët, vërtetohet edhe nga provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesor e që janë “Ekstrakti me numër, kopja e letërnjoftimit e shtetit të Belgjikës me emrin e personit J...K..... si dhe Formulari për Aplikim, i datës 31.07.2023.

Nuk ishte kontestues për gjykatën as fakti se për të pandehurin A...M....., në bazë të aplikimit të tij pranë ARC-së, i ishte lëshuar letërnjoftimi me numër, data e lëshimit 01.08.2023, me numër personal, me emrin J...K....., i lindur me datë 03.08.1990, në fshatin D....., Komuna Istog, e në të cilin letërnjoftim është fotografia e të pandehurit A...M.....

Nuk ishte kontestues as fakti se i pandehuri i dytë, Sh...H....., në Agjencinë për Regjistrim Civil – Drejtoria për Pajisje me Dokumente, në cilësi të dëshmitarit, nën përgjegjësi të plotë morale dhe penale, kishte dhënë deklaratë se personi për të cilin kishte shkuar për të dëshmuar (J...K....., me numër personal,) ishte personalisht ai dhe se të dhënat e këtij personi, ishin të vërteta dhe se në këtë deklaratë, dëshmitari, këtu i pandehuri Sh...H....., ishte paralajmëruar se deklarimi i rremë është vepër penale dhe dënohet sipas ligjit. dhe ky fakt, përveç se nuk është kontestuar nga palët, vërtetohet edhe nga prova materiale “Deklaratë”, e dhënë nga ky i pandehur pranë ARC-së.

Gjykata vëren se kontestuese në këtë çështje penale ishte nëse të pandehurit A...M..... dhe Sh...H....., kanë kryer veprat penale respektive për të cilat akuzohen, pasi që siç pretendon mbrojtja e

të pandehurit të parë, vepra penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së, nuk është arritur të kryhej, ndërsa për veprën penale Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes, për vet faktin se nuk është ankuar askush se i është vjedhur identiteti, edhe nuk është kryer kjo vepër penale. Ndërsa i pandehuri i dytë Sh...H....., është mbrojtur me faktin se ka qenë i mashtruar nga persona të tjerë dhe është vënë në lajthim, edhe pse nuk e ka mohuar se të pandehurin e parë, e as personin J....K....., nuk i ka njohur asnjëherë.

Nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, në kuptim të nenit 7 dhe 360 të KPP-së, Gjykata ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se të pandehurit A...M..... dhe Sh...H....., ditën kritike, me datë 31.07.2023, kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, përkatësisht i pandehuri i parë A...M....., ka kryer veprat penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprën penale Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri Sh... H..., veprën penale Deklarimet e rreme nga neni 384 paragrafi 1 të KPRK-së.

Para së gjithash, këtë gjendje faktike lidhur me të pandehurin A...M....., sa i përket veprës penale sipas pikës I të dispozitivit, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së, gjykata e ka vërtetuar nga provat materiale, ashtu që, se i pandehuri ka legalizuar përmbajtje të rreme pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil – Drejtoria për Pajisje me Dokumente, vërtetohet nga Ekstrakti i Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile, me numër serik, i lëshuar në F..... B....., Komuna Gjakovë, i datës 11.07.2023, në emrin e personit J....K....., i lindur me datë 03.08.1990 në Fshatin D....., Komuna Istog, me numër personal, nga i ati S....., e ëma P....., si dhe letërnjoftimi i shtetit të Belgjikës me emrin e personit J....K....., me numër të kartës, e të cilat dokumente, i pandehuri A...M....., ia kishte prezantuar Agjencisë së Regjistrimit Civil – Drejtorisë për Pajisje me Dokumente, duke i vënë në lajthim të njëjtit se është personi J....K..... dhe krejt kjo me qëllim që të pajiset me letërnjoftim të Kosovës, në emër të personit tjetër.

Gjithashtu, kjo vërtetohet edhe nga Formulari për Aplikim, i paraqitur nga i pandehuri A...M....., i datës 31.07.2023, me numër, përmes të cilit, i pandehuri, në procedurë urgjente, kishte aplikuar për nxjerrjen e letërnjoftimit të Kosovës, për çka edhe kishte bërë pagesën në Postën e Kosovës në të njëjtën datë. Formulari në fjalë, tek të dhënat e aplikuesit, përmban shënimet, përkatësisht gjeneralet e personit J....K....., i lindur me datë 03.08.1990 në Fshatin D..... të Istogut, me numër personal të identifikimit, nga i ati S.... dhe e ëma P.....

Se është kryer vepra penale e legalizimit të përmbajtjes së rreme nga ana e këtij të pandehuri, vërtetohet nga prova materiale, letërnjoftimi i lëshuar nga ARC në emrin e J....K....., me numër, data e lëshimit 01.08.2023, me numër personal, i lindur me datë 03.08.1990, në fshatin D....., Komuna Istog, e në të cilin letërnjoftim është fotografia e të pandehurit A...M.....

Nga prova materiale, “Lidhjet Familjare”, të administruara si provë në shqyrtim gjyqësor, vërtetohet se personi J....K....., është i lindur me datë 03.08.1990, në Fshatin D....., Komuna e Istogut, me numër personal të identifikimit, nga i ati S....., e ëma P....., i cili sipas këtyre të dhënave, figuron që ka hyrë në Kosovë vetëm në vitin 2014. Në këtë dokument, po ashtu janë

edhe të dhënat personale për prindërit e personit J....K....., S.... dhe P.... K...., përfshirë edhe certifikatën e martesës së tyre.

Gjykata ka vlerësuar si plotësisht të besueshme provat materiale, përkatësisht formularin për aplikim, ekstraktin me numër, i lëshuar në Fshatin B....., Komuna Gjakovë, i datës 11.07.2023, në emrin e personit J....K....., letërnjoftimi i shtetit të Belgjikës në emrin e personit J....K....., me numër të kartës, letërnjoftimi i lëshuar nga ARC në emrin e J....K....., me numër, data e lëshimit 01.08.2023, me fotografën e të pandehurit A...M.... si dhe të dhënat familjare sa i përket personit J....K....., pasi që këto prova materiale, janë lëshuar nga institucionet publike, të njëjtat i kishin në dispozicion të gjitha palët në proces, janë administruar në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe kanë vlerë provuese të pa kontestueshme, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate.

Neni 395 paragrafi 1 i KPRK-së, ka përcaktuar se: *“1. Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.”.*

Nga të lart cekurat, përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së përkatësisht se në veprimet e tij, janë konsumuar elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale për të cilën akuzohet dhe është shpallur fajtor, andaj edhe nuk ka mundur të pajtohet me pretendimet e mbrojtjes se kjo veprë, nuk ka arritur të kryhet/përfundohet. Kjo për faktin sepse është vërtetuar se i pandehuri, në ditën kritike, ka vënë në lajthim organin publik, Agjencinë e Gjendjes Civile – Drejtoria për Pajisje me Dokumente, ashtu që i vetëdijshëm, në mënyrë mashtruese, ka legalizuar diçka të pa vërtetë, kur me rastin e aplikimit për letërnjoftim të Republikës së Kosovës, ka prezantuar një ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile dhe një letërnjoftim të shtetit të Belgjikës, të dyja këto në emrin e personit J....K....., pra krejt kjo, me qëllim që të krijohet lajthitja te organet e administratës se ekziston një fakt relevant, i vërtetë juridik, se ai (i pandehuri) është personi në fjalë (pra J....K.....), dhe krejt kjo me qëllim që të pajiset me mjet të ri identifikimi (letërnjoftim të Republikës së Kosovës). Pra veprimet e të pandehurit A...M....., haptazi janë veprime të kundërligjshme, të sanksionuara me ligj si veprë penale, esenca e të cilës veprë penale, sipas vet germës së ligjit por edhe doktrinës juridike, qëndron në faktin se organi kompetent vepron në lajthitje dhe kjo në bazë të veprimeve të cilat i ka ndërmarrë kryesi.

Sa i përket veprës penale si në pikën II të dispozitivit, Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes nga neni 336 paragrafi 1 të KPRK-së, nga i pandehuri A...M....., gjykata ka vërtetuar kryerjen e kësaj veprë penale, nga provat materiale të administruara në shqyrtim kryesor. Kjo bazuar në faktin sepse i pandehuri, pa asnjë autorizim ligjor, ka përdorur mjetin e identifikimit të personit tjetër dhe atë ekstraktin me numër, të lëshuar në Fshatin B....., Komuna e Gjakovës, me datë 11.07.2023, në emër të personit J....K....., dhe krejt kjo, siç u potencua edhe më lartë, me qëllim që të pajiset me mjet identifikimi për vetën e tij, por me të dhëna të një personi tjetër

Nga prova materiale, Formulari për Aplikim, i datës 31.07.2023, përmes të cilit i pandehuri ka aplikuar, në procedurë urgjente, për lëshimin e letërnjoftimit, vërtetohet se të dhënat në këtë formular, siç u theksua edhe më lartë, janë të personit me emrin J....K.....

Veprën penale sipas pikës II të dispozitivit, i pandehuri A...M....., e ka kryer gjatë dhe në lidhje me një veprë tjetër penale, përkatësisht me veprën penale si në pikën I, ashtu që fillimisht ka shfrytëzuar mjetin e identifikimit të personit tjetër, pa autorizim ligjor, përkatësisht ekstraktin nga me numër, të lëshuar në Fshatin B....., Komuna e Gjakovës, në emrin e J....K....., e krejt kjo me qëllim që organin publik kompetent ta vejë në lajthim në mënyrë që të njëjtit të legalizojnë diçka të pavërtetë, pra të legalizojnë se i pandehuri A...M....., është personi me të dhënat e personit J....K....., dhe kjo do të bëhej me rastin e lëshimit të letërnjoftimit.

Neni 336, paragrafi 1, ka përcaktuar se: *“1. Kushdo që gjatë dhe në lidhje me ndonjë veprë tjetër penale, me përjashtim të neneve 114- 139, me dashje transferon, posedon ose shfrytëzon, pa autorizim ligjor, mjetin e identifikimit të personit tjetër, pajisjen e qasjes, ose informacionin e identifikimit të telekomunikimit, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.”*, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen, ka përcaktuar se çka nënkuptojmë me mjet identifikimi, dhe kjo dispozitë përcakton se: *“3. Për qëllim të këtij neni, shprehja “mjet identifikimi” nënkupton cilindo emër ose numër që mund të përdoret, i vetëm apo në lidhje me ndonjë informacion tjetër, për të identifikuar një individ të caktuar, përfshirë emrin, datën e lindjes, lejen e vozitjes apo numrin e identifikimit, numrin e pasaportës, numrin e identifikimit të punëdhënësit ose tatimpaguesit, të dhënat unike biometrike, siç janë gjurmët e gishtave, mostra e zërit, imazhi i retinës apo irisit, ose ndonjë karakteristikë tjetër unike fizike; numrin unik të identifikimit elektronik, adresën, ose kursin.”*

Pra, sipas interpretimit të kësaj vepre penale, përkatësisht paragrafit 1 të nenit 336, kjo veprë mund të kryhet nga çdo person pa përjashtim dhe e njëjta mund të kryhet vetëm me dashje. Tutje, kjo veprë duhet të kryhet gjatë dhe në lidhje me një veprë tjetër penale. Është e qartë për këtë gjykatë se, siç u thekua edhe më lartë, i pandehuri këtë veprë penale, e ka kryer në lidhje me një veprë tjetër penale, atë nga pika I e dispozitivit, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 1 të KPRK-së. Kryerësi i kësaj vepre penale, nuk duhet të ketë asnjë autorizim ligjor që të veprojnë në atë formë, pra që ta transferoj, posedoj apo shfrytëzoj mjetin e identifikimit të personit tjetër, që në rastin konkret, ishte e qartë që i pandehuri A...M..... nuk kishte një autorizim të tillë si dhe element tjetër i rëndësishëm i figurës së kësaj vepre penale është shfrytëzimi (ndër të tjera) i mjetit të identifikimit të personit tjetër, e që në veprimet e të pandehurit, nga provat e administruara, është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë, se i njëjti ka shfrytëzuar mjetin e identifikimit të personit J....K....., me qëllim aplikimi për letërnjoftim të Republikës së Kosovës.

Sa i përket të pandehurit Sh....H....., kjo Gjykatë ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv, dhe kjo gjendje faktike, vërtetohet nga provat materiale të administruara në shqyrtim kryesor por edhe nga vetë mbrojtja e të pandehurit.

Nga prova materiale “Deklaratë”, të cilën këtu i pandehuri Sh....H..... e ka dhënë në cilësi të dëshmitarit pranë organit administrativ, përkatësisht para Agjencisë për Regjistrim Civil – Drejtoria për Pajisje me Dokumente, vërtetohet se i pandehuri, nën përgjegjësi të plotë morale dhe penale, ka deklaruar se personi për të cilin ishte aty, ishte personalisht ai dhe identiteti dhe të dhënat e tij, ishin të sakta. Pra sipas kësaj deklaratë, i pandehuri Sh....H....., kishte deklaruar për të pandehuri A...M....., se është J....K....., me numër personal

Këtë deklaratë, i pandehuri e kishte dhënë dhe nënshkruar përkundër se në dokumentin e njëjtë saktësohet se deklarimi i rrejshëm, është veprë penale dhe dënohet sipas ligjit.

Një gjendje e tillë faktike, është vërtetuar edhe nga vet mbrojtja e të pandehurit dhënë në shqyrtim kryesor, i cili ndër të tjera ka konfirmuar se ka qenë në zyrat e ARC-së, se ka dhënë dhe nënshkruar deklaratën në cilësi të dëshmitarit dhe se nuk ka njohur, asnjëherë dhe në asnjë rrethanë, as të pandehurin A...M..... dhe as personin J...K....., dhe se atë deklarim e ka bërë pasi që ka qenë i joshur nga shuma e parave të cilat i ka marrë, pra shuma prej 1,600.00 euro, të cilat para, siç ka theksuar i pandehuri, i ka pranuar nga një person me emrin M...N....j.

Gjykata e ka vlerësuar si plotësisht të besueshme provën materiale, respektivisht deklaratën e dhënë nga i pandehuri në cilësi të dëshmitarit në zyrat e ARC-së, përmes të cilës ka deklaruar, siç u sqarua më lartë, se këtu i pandehuri i parë, A...M....., është J...K..... kjo për faktin se këtë deklaratë, i pandehuri e ka dhënë para organit shtetëror administrativ, e ka dhënë dhe nënshkruar në mënyrë vullnetare, duke qenë i paralajmëruar sipas vet përmbajtjes së deklaratës se deklarimi i rremë, përbën veprë penale e cila dënohet sipas ligjit. Kjo provë materiale, ka vlerë provuese, është relevante dhe kredibile, andaj edhe për këto arsye, është e pa kontestueshme, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate.

Neni 384 paragrafi 1 i KPRK-së, ka përcaktuar se: *“1. Pala, dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore ose penale, procedurën paraprake, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore jep deklaratë, ekspertizë ose raport të rremë dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit.”.*

Nga të lart cekurat, përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale si në pikën III të dispozitivit, Deklarimet e rreme nga neni 384 paragrafi 1 të KPRK-së, përkatësisht se në veprimet e tij, janë konsumuar elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale për të cilën akuzohet dhe është shpallur fajtor. Kjo për faktin sepse është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri Sh...H....., ditën kritike, ka dhënë një deklaratë, nën përgjegjësi të plotë morale dhe penale, se personi për të cilin kishte shkruar të jepte deklaratë, këtu i pandehuri A...M....., është personi J...K..... Deklaratën e rreme në fjalë, i pandehuri e kishte dhënë para organit administrativ, e cila deklaratë do t'i shërbente më vonë të pandehurit të parë A...M..... në procedurën për nxjerrjen e letërnjoftimit, ashtu që kjo deklaratë kishte të bënte me fakte relevante juridike e që ka të bëjë me të dhënat personale, përkatësisht gjeneralet e një personi siç janë emri, mbiemri, numri personal, pra thjeshtë identiteti i personit. Nga arsyet e dhëna si më lartë, është vërtetuar se deklarimi i të pandehurit ishte i pa vërtetë për shkak se personi për të cilin i pandehuri kishte deklaruar se është J...K....., në fakt nuk ishte, dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e dinte se deklarimi i tij, nuk kishte të bënte me realitetin pasi që siç ka theksuar i pandehuri, ai nuk kishte njohur në asnjë rrethanë as të pandehurin A...M..... e as personin J...K....., porse veprimin e kishte bërë kryekëput për motive të përfitimit material pasi që kishte qenë i joshur nga shuma që kishte marrë, shumën prej 1,600.00 euro.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi sa i përket të pandehurve A...M..... dhe Sh...H....., duke i shpallur të njëjtit fajtor, pasi që në bazë të provave të administruara, u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme se

në veprimet e këtyre të akuzuarve, janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprave penale për të cilat akuzohen të njëjtit sipas aktakuzës.

Gjykata e ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit Sh....H....., ku i njëjti ka pretenduar se ka qenë i shtyrë dhe nën ndikim nga një person me emrin M....N....j për të kryer këtë veprë, mirëpo kjo, sipas vlerësimit të gjykatës, është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe pretendimet e këtij të pandehuri janë në kundërshtim të plotë me provat e administruara por edhe me vet mbrojtjen e tij.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPPK-së.

Gjykata, si rrethana rënduese për të pandehurin e parë A...M..... ka vlerësuar shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e këtyre veprave penale, motivet për të cilat janë kryer veprat penale pasi që nga shkresat e lëndës, vërtetohet se i njëjti është në kërkim ndërkombëtar përkatësisht në listën e personave të kërkuar nga INTERPOL-i andaj edhe motiv i kryerjes së këtyre veprave penale, është shmangia nga ndjekja penale dhe vënia e tij para organeve të drejtësisë.

Ndërsa, si rrethana lehtësuese për të pandehurin, është vlerësuar sjellja përgjithësisht korrekte e tij në gjykatë.

Sa i përket të pandehurit të dytë Sh....H....., gjykata si rrethana rënduese, ka vlerësuar dashjen e lartë për kryerjen e veprës penale, motivet që kanë shtyrë këtë të pandehur për kryerjen e veprës penale për shkak se i pandehuri këtë veprë penale e kishte kryer me qëllim përftimi material, kjo për arsye sepse siç ka theksuar, për këtë veprim kishte marrë shumën prej 1,600.00 euro, gjithashtu si rrethana rënduese, gjykata ka gjetur edhe faktin se i pandehuri Sh.... edhe më parë ka qenë i dënuar me vendim të plotfuqishëm pasi që nga evidenca penale, vërtetohet se i njëjti ka pesë raste të pa shlyera penale dhe atë: përmes Aktgjykimit numër P.nr.1066/2016, i plotfuqishëm me datë 08.03.2017, i dënuar për veprën penale të Kanosjes; Aktgjykimit numër P.nr.37/2001, i plotfuqishëm me datë 28.01.2003, i dënuar për veprën penale të Përdorimit të armës; Aktgjykimit numër P.nr.3636/2016, i plotfuqishëm me datë 30.04.2019, i dënuar për veprën penale të Kanosjes; Aktgjykimit numër P.nr.730/2021, i plotfuqishëm me datë 26.04.2022, i dënuar për veprën penale të Vjedhjes dhe Aktgjykimit numër P.nr.789/2006, i plotfuqishëm me datë 23.10.2012, i dënuar për veprën penale të Mashtrimit. Andaj të gjitha këto, tregojnë se ky i pandehur, është përsëritës i veprave penale, çka tregon për karakterin, personalitetin dhe të kaluarën e të njëjtit. Si rrethana rënduese, gjykata ka gjetur edhe sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pasi që i njëjti, në raste të caktuara ka penguar punën e gjykatës dhe kjo vërtetohet edhe përmes procesverbalit të shqyrtimit fillestar ku gjykata është detyruar që të pandehurit Sh....., t'ia tërheqë vërejtjen.

Ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të pandehurit, pasi që i njëjti është baba i tre fëmijëve.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit A...M..... dhe dënim me burgim

dhe gjobë ndaj të pandehurit Sh...H....., janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurve. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehurit të përmbahen nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata, me aktvendim të veçantë, të pandehurit A...M....., ia ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e Aktgjykimit, por jo më shumë se sa dënimi i shqiptuar, ndërsa llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit, në dënimin e shqiptuar, gjykata e ka bërë bazuar në nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së.

Refuzimi i propozimeve të palëve:

Gjykata, në shqyrtim kryesor, ka refuzuar propozimet e të pandehurit Sh... H....., që në cilësi të dëshmitarit të dëgjoheshin M...N....j, togeri Q...A.... si dhe ofiqarin që ka lëshuar ekstraktin në emrin e personit J...K..... Kjo për arsye sepse sa i përket personit M...N....j, gjykata ka vlerësuar se arsyet e dhëna nga i pandehuri, nuk do të ndikojnë në zbardhjen e ndonjë elementi të veprës penale, për më tepër, nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata para se të refuzoj propozimin e të pandehurit për këtë dëshmitar, është informuar se për pretendimet e të pandehurit Sh... H..., në raport me personin M...N....j, ndaj këtij të fundit tashmë ishte hapur rast, i cili ishte ceduar në Gjakovë si kompetente territoriale. Sa i përket dëshmitarit Q...A....., i njëjti ishte propozuar nga ana e të pandehurit duke pretenduar se ky dëshmitar, ka bërë lëshime në punën e tij lidhur me hetimin e rastit, mirëpo gjykata ka refuzuar edhe këtë propozim për faktin se objekt i akuzës, nuk ishin veprimet e hetuesit policor por veprimet e të pandehurve. Përfundimisht, sa i përket ofiqarit i cili ka lëshuar ekstraktin për personin J...K....., i pandehuri e ka propozuar me arsyetimin se ky dëshmitar, do të dëshmonte se i pandehuri Shefki, nuk ka qenë asnjëherë në Gjakovë, por që ky fakt nuk ishte kontestues pasi që veprën penale, i pandehuri e kishte kryer në Mitrovicë dhe jo në Gjakovë, prandaj për këto arsye edhe ka refuzuar edhe këtë propozim.

Refuzimin e këtyre propozimeve gjykata e ka bazuar në nenin 252 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 dhe 2.4 të KPP-së.

Gjithashtu, gjykata ka refuzuar edhe propozimin e të pandehurit Sh...H....., që në cilësi të provave materiale, të administroheshin komunikimet e të njëjtit me personin M...N....j, pasi që siç ka arsyetuar i pandehuri, këto do të dëshmonin se ata janë njohur dhe se nuk qëndrojnë pretendimet e M...N....j se nuk janë njohur, por një propozim i tillë, është refuzuar për faktin se kjo nuk kishte të bënte fare me objektin e akuzës.

Gjykata ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij Aktgjykimi dhe ka urdhëruar konfiskimin e sendeve dhe atë Letërnjoftimi me numër serik me të dhënat e J...K..... me numër personal si dhe një Letërnjoftim me numër serik me të dhënat e V.... F.... i lëshuar nga Republika e Shqipërisë. Kjo duke u bazuar në nenin 270 paragrafi 1 të KPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *“1. Para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin kryesor se pasuria ishte mjet i veprës*

penale për të cilën i pandehuri është dënuar.”, e lidhur me nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.36 dhe 1.38, pika 1.38.1 të KPP-së.

Gjykata ka vendosur si në pikën VI të dispozitivit të këtij Aktgjykimi ashtu që ka urdhëruar kthimin e sendit dhe atë një telefon I phone 8, ngjyrë e zezë, i cili telefon kishte qenë objekt i Urdhrit Ndalues Përfundimtar, i lëshuar nga kjo Gjykatë me datë 15.08.2023, kjo për arsye sepse në aktakuzë nuk është propozuar konfiskimi i këtij telefoni.

Vendimin për shpenzimet e procedurës sa i përket të pandehurve, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas Aktakuzës, pala të dëmtuar në këtë çështje penale, nuk kishte.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 270, 359, 360, 364, 366, 449, 450 dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.437/2023, datë 07.03.2024

Procesmbajtësja
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.